



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1363_08_15**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **28.08.2015**;

në seancën e mbajtur më datë 28 janar 2015, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit H.O. me shifër DPR - 206511 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1363_08_15** i datës 11.08.2015.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 28.08.2015 ka pranuar ankesën e konsumatorit Abaz Osmanit me te cilën ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, i cili ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që të shqyrtoi ankesën e lidhur me faturën e energjisë elektrike të muajit shtator 2014 të ngarkuar nga KEDS-i. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se për shkak të mos regjistrimit të shpenzimit në të dy tarifat, si dhe dyshimit në harxhim më të lartë është bërë kërkesa për ndërrim njehsori. Konsumatori në vazhdim të ankesës ka theksuar se kur zyrtarët e KEDS-it erdhën në gusht të vitit 2014 për të bërë ndërrimin e njehsorit elektrik ata e djegën një njehsor elektrik, dhe se të nesërmen ata prapë bënë ndërrimin e njehsorit elektrik por që në shtëpi nuk ka qenë askush. Konsumatori ka theksuar se pesë ditëve prapë disa zyrtarë të KEDS-it kanë bërë kontrollimin e pikës matëse dhe kanë konstatuar se pse po shpenzohet gjithë kjo energji në pikë matëse dhe se gjatë kontrollimit të pajisjeve kanë theksuar se është mirë të merret një elektrikist për të bërë verifikimin e shpenzimit. Konsumatori gjithashtu ka theksuar se ku elektrikisti ke theksuar se është e mundur që një kablo është dëmtuar gjatë ndërrimit të njehsorit elektrik.

Me datë 26.09.2014 Departamenti i Faturimit në KEDS i ka dërguar konsumatorit dy fatura të energjisë elektrike për periudhën 09/2014, ku njëra konsumatorit i ka shkuar me shpenzim e njehsorit elektrik të vjetër nr.10569482 me shpenzim prej 455 kWh apo shprehur në vlerë financiare prej 23.36€, dhe tjetra me njehsorin e ri nr.63821385 me shpenzim prej 2,664 kWh apo shprehur në vlerë financiar prej 181.02€.

Pas arritjes së faturës së muajit 09/2014 punëtorët e autorizuar të kontrollës së KEDS-it me datë 08.09.2014 kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.



10569482 me gjendje TL=65406 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=30187 kWh (tarifa e ulët), dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektirk nr. 63821385 me gjendje TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh.

Me datë 25.09.2014 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kundërshtuar faturimin e energjisë elektrike të muajit 09/2014 dhe ka kërkuar verifikimin e njehsorit elektrik për shkak se njehsori ka shpenzuar më tepër se në realitet që është shpenzuar

Pas ankesës së konsumatorit punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 16.09.2014 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, dhe kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 63821385 ku TL=001447 kWh dhe TU=001034 kWh.

Pas ankesës së konsumatorit, Departamenti për Konsumator në KEDS me datë 30.09.2014 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe procesverbalin e inspektimit nr. 1616518 të datës 16.09.2014.

I pakënaqur me përgjigjen e KEDS-it, konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së ku në ankesën e tij ka theksuar se kundërshton shpenzimin e faturuar në muajin 09/2014 ku sipas tij është e pamundur të bëhet gjithë ai shpenzim.

Departamenti për Mbrojtjen e konsumatorëve në ZRRE me datë 11.08.2015 ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit ka nxjerrë vendim duke e refuzuar ankesën e konsumatorit si të pabazuar.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e konsumatorit nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se vendimi i DMK-së nuk është i mbështetur në prova dhe në ligj.

Kundërshtimi i ankuesit se konsumatori vet ka kërkuar ndërrimin e njehsorit elektrike duke parë mos regjistrimin e energjisë në të dy tarifat dhe nën dyshimin e shpenzimit të energjisë elektrike për shkak të harxhimit të tepërt, Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik dhe ka konstatuar se në procesverbal theksohet se ndërrimi i njehsorit elektirk bëhet sipas projektit të KEDS-it dhe jo me kërkesë të konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe kundërshtimin tjetër të ankuesit lidhur me atë se punëtorët e KEDS-it gjatë ndërrimit të njehsorit elektrik kanë djegur njehsorin elektrik dhe se në procesverbalin e kontrollës kanë theksuar se njehsori elektrik është duke shpenzuar shumë. Bordi i ZRRE gjatë analizimit të procesverbalit të ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 0116465 të datës 08.09.2014 dhe procesverbalit të kontrollës nr. 1622518 të datës 16.09.2014 ka konstatuar se në asnjërin prej procesverbaleve nuk është evidentuar ndonjë defekt teknik të pikës matëse apo djegie e pikës matëse ashtu siç konsumatori pretendon në ankesën e tij, si dhe njehsori i ri i montuar nr. 63821385 vazhdon edhe më tutje të jetë në funksion te konsumatori.

Bordi i ZRRE ka analizuar edhe kundërshtimin tjetër të konsumatorit se për një periudhë 5 ditore njehsori elektrik ka regjistruar tepër energji elektrike. Sa i përket këtij kundërshtimi të konsumatorit, Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimet e energjisë elektrike të këtij konsumatori me njehsorin elektrike nr. 10569482 dhe nr. 63821385 (para dhe pas kontestit të muajit 09/2014) vërehet se nuk ka ndryshim të madh të shpenzimit të shpenzimit mes njehsorëve, dallimi i vetëm është ai periudhës 09/2014, por që sipas të dhënave të evidentuar më lartë në procesverbalin e KEDS-it të ndërrimit të njehsorit elektri nr. 0116465 të datës 08.09.2014 dhe procesverbalin të inspektimit nr. 1622518 të datës 16.09.2014 gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e nejhisorit elektirk nr. 63821385 përputhet me gjendjen e shpenzimit në rrjedhën e energjisë elektrike dhe se nuk është vërjetur ndonjë defekt teknik i cili do të regjistronte shpenzim të energjisë elektrike më të lartë. Bordi i ZRRE-



së gjatë analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit elektrik nr. 1622518 dhe ka vërejtur se konsumatori faturim të ngjajshëm si ajo e periudhës 09/2014 ka pasur edhe në periudhat tjera.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1363_08_15, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit H.O.,
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së